



100 Vjet Pavarësi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2138, datë 2.08.2012

Për

“Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit - Konsultim Publik”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 2.08.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit - Konsultim Publik”

- Dokumentacioni i Grupit të Punës përbëhet nga:
- Projekt vendimi
- Relacioni Shoqërues i projekt vendimit
- Dokumenti: Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit - Konsultim Publik”

BAZA LIGJORE:

1. Nenet 31 e në vijim i Kreut VI të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);
2. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (*ligji nr. 8485*), i ndryshuar;
3. Pika 1, germa (e) dhe pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (ish ERT)” (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues (*VKD*) të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;
4. Rregullore për analizën e tregut, miratuar me VKD nr.747, date 17.07.2009;
5. Udhëzues për Procedurat e Keshillimit me Publikun miratuar me VKD nr.1183, datë 10.03.2010.

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

V Ë R E N:

1. Dokumentacioni i paraqitur nga Grupi i Punës i ngritur me Urdhërin nr.825 datë 20.04.2012 përbëhet nga:
 - a. Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485;
 - b. *Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit - Konsultim Publik*, i cili përmban analizën e tregut për FNT për tregjet mr pakicë dhe tregjet me shumicë të Rregullores së Analizes së Tregut si edhe detyrimet e propozuara për FNT në këto tregje të analizuara;
 - c. Relacioni shpjegues për Projektvendimin e KD dhe dokumentin e Analizës së tregut;
2. Dokumenti: “*Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit - Konsultim Publik*”, është një dokument rregullator shumë i rëndësishëm dhe masat rregulluese që do të merren në vartësi të gjetjeve për FNT pas procesit të konsultimit publik, kanë një ndikim të rëndësishëm në tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësine e miratimit të dokumentit të cituar me lart, bazuar në pikën 1 të nenin 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe pika 17, neni 21 të Rregullores së Brendëshme të AKEP, e ndryshuar,

V E N D O S:

1. Të miratojë nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit “*Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit - Konsultim Publik*” (bashkangjitur).
2. Proçedura e këshillimit publik për dokumentin e analizës së tregut si dhe detyrimeve të propozuara për FNT, të cilat janë pjesë e dokumentit të analizës, të kryhet, nga data 3/08/2012 deri më 3/10/2012.
3. Ky vendim dhe dokumenti “*Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit - Konsultim Publik*” të publikohen në faqen e internetit www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURCE



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

ANALIZE E TREGUT

TE TELEFONISE FIKSE

- 1) Tregu i aksesit ne rrjet publik telefonik nga vendodhje fikse;
- 2) Tregu i thirrjeve telefonike te vlefshme per publikun nga vendodhje fikse.
- 3) Tregu me shumice i origjinimit te thirrjeve ne rrjetin telefonik publik te ofruara nga vendndodhje fikse .
- 4) Tregu me shumice i terminimit te thirrjeve per rrjete publike telefonike individuale te ofruara nga vendndodhje fikse.
- 5) Tregu me shumice i sherbimeve transite ne rrjetet telefonike publike fikse.

Dokument per Konsultim Publik Gusht 2012

(MIRATUAR ME VKD NR. ___DATE___2012)

PUBLIKUAR NE www.akep.al ne seksionin Konsultime ne Proces